



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. exho Prot / Q.Sh.

Tiranë, më 21.02.2026

Lënda : Dërgohet urdhri i prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal nr.50 datë 21.02.2026,

Drejtuar:

INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

DURRËS

Av: Ilir Murati

Adresë: Rruga "Jordan Misja", Pallati 1, Shkalla 3, Kati I, Ap. 22,

TIRANË

Bashkëlidhur ju dërgojmë urdhrin e prokurorit datë 21.02.2026, për ekzekutimin e shkurtimit të vendimit penal nr.50, datë 21.02.2026, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shuarjen e masës së sigurimit personal "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 të K. Pr. Penale, për të pandehurin Jurgis Çyrbja, si dhe një kopje të vendimit përkatës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

Klodjan Braho

K. Braho



Adresa: Rruga "Jordan Misja" nr. 1 Tiranë

website: www.spak.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

URDHËR

*Për ekzekutimin e shkurtimit të vendimit penal nr. 50 datë 21.2.2026, të Gjykatës së
Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për të pandehurin Jurgis
Çyrbja*

Në Tiranë, sot më datë **21.2.2026**.

Unë, **Adnan Xholi**, prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, pasi u njoha shkurtimin e vendimit penal **Nr. 50, datë 21.2.2026**, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të pandehurin:

Jurgis ÇYRBJA i biri i Shefqet dhe i Drita, i datëlindjes 15.07.1985, lindur në Shijak dhe banues fshati Sallmone, Nd. 002, Njësia administrative Xhafzotaj, 2018, Bashkia Shijak, me shtetësi shqiptare, me gjendje civile beqar, mbajtës i dokumentit identifikues kartë identiteti me nr. personal (ID) I 50715014 K, i hetuar me masë sigurimi personal “*arrest me burg*”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale, të caktuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, me vendimin Nr. 126, datë 20.10.2024, (e ekzekutuar më datë 20.10.2024), mbrojtur nga avokati i zgjedhur z. Ilir MURATI, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me Nr. Licence Nr. 1216, me Nr. NUIS K 61912001 V, me adresë Rruga “Jordan Misja”, Pallati 1, Shkalla 3, Kati I^{rë}, Ap. 22, Tiranë.

KONSTATOVA:

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, **me shkurtimin e vendimit penal nr. 50, datë 21.02.2026, ka vendosur:**

- Shuarjen e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar me Vendimin nr. 126, datë 20.10.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj të pandehurit Jurgis Çyrbja.

- ***Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit Jurgis Çyrbja nga ambientet e paraburgimit, nëse nuk mbahet në to për efekt të ndonjë vendimi tjetër penal.***

Vendimi në ngarkim të tij u shpallë sot më datë **21.02.2026** në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar .

Për këto arsye, bazuar dhe në kërkesat e neneve 462, 463, 261/1 **466** të K.Pr.Penale dhe neneve 11, 12, 13, 21 të ligjit nr. 79 datë 25.06.2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”,

URDHËROJ:

1. Ekzekutimin e shkurtimin të vendimit penal **nr. 50, datë 21.02.2026**, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të pandehurin **Jurgis ÇYRBJA**.

2. Me zbatimin e këtij urdhri ngarkohet: Drejtoria e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, e cila të ekzekutojë vendimin e mësipërm për:

- ***Shuarjen e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar me Vendimin nr. 126, datë 20.10.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj të pandehurit Jurgis ÇYRBJA.***
- ***Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit Jurgis ÇYRBJA nga ambientet e paraburgimit, nëse nuk mbahet në to për efekt të ndonjë vendimi tjetër penal.***

3. Për fillimin e përfundimin e ekzekutimit të vendimit, të bëhet njoftimi zyrtarisht i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë.

4. Ky urdhër u përpilua në 3 kopje një kopje i dërgohet I.E.V.P Durrës një kopje i komunikohet të pandehurit **Jurgis ÇYRBJA**, dhe një kopje për fashikullin hetimorë.

PROKURORI

Adnan Xholi

